



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2562/2 prot

Datë 23.10.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË TJERË

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “2AS INVEST” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-81066-09-25-2023., me objekt “*Blerje bazë materiale për ndriçimin rrugor*”, me fond limit 3.872.440 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 06.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik AA&P SHPK. .

Ankimues: Operatori ekonomik “2AS INVEST” SHPK, me Nipt M11803504B
Adresa: Lagjja 13, Plazh, Zona Kadastrale 8518, Nr.Pasurie 58/338+1-43, kati tetë, Durrës.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Patos.
Adresa: Lagjja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, Patos.

Subjekt i interesuar: Operatori ekonomik “AA&P” SHPK
Adresa: Njësia Bashkiake nr.6, Rr: "Tanush Frasheri", Pallati "B&K" konstrukt, Tiranë

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “2AS INVEST” SHPK me numër ankimi elektronik A/2023/3516, datë 20.10.2023, dhe me nr. 2562/2023 prot., datë 23.10.2023 për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-81066-09-25-2023., me objekt “*Blerje bazë materiale për ndriçimin rrugor*”, me fond

limit 3.872.440 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 06.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e operatorit ekonomik "AA&P" SHPK, në procedurën e mësipërme e prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërmat "b" dhe "c" të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", ku parashikohet se: "Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime."

Komisioni i Prokurimit Publik publikon pretendimet e operatorit ekonomik "2AS INVEST" SHPK mbi shfuqizim të vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik AA&P SHPK:

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje të kriterëve si më poshtë vijon:

2.3.4. Operatorët ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar për mallrat e kërkuara objekt prokurimi.

2.3.5. Operatorët ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit duhet të dorëzojnë në ambjentet e magazinës pranë Bashkisë Patos brenda datës 06/10/2023 ora 11:00, (para hapjes së fazës së vlerësimit nga KVO përkatëse) mostrat për zërat si më poshtë:

Nr.	Nr. Anal.	Emertimi	Njesia	Sasia
1	treg	Ndriçues LED 50 W	copë	1
2	treg	Ndriçues LED 100 W	copë	1
4	treg	Ndriçues LED me Panel diellor	copë	1

Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për rëndësinë e mallrave dhe përshtatshmerinë që duhet të kenë në objektet ekzistuese ndaj është e nevojshme sjellja e mostrave.

Shënim: Ky kriter përbën kusht skualifikimi në rast se mostrat e dorëzuara nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Mosparaqitja mostrave përbën kusht për skualifikim. Mostrat e dorëzuara do të kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostra i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

Ankimuesi kërkon:

AK të anulohet procedurën.

Të vlerësojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë.

Te skualifikohet AA&P SHPK.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 23.10.2023

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri